



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 35 .

Prishtinë, më 7.3.2019, në ora 9:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Danush Ademi zëvendëskryetarë i dytë, Fadil Beka, Haxhi Shala, Rasim Selmanaj, Albert Kinolli, Slobodan Petroviç. Duda Balje dhe Veton Berisha, anëtarë.

Munguan: Igor Simiq, Xhelal Sveçla, Kujtim Shala, Jasmina Zhivkoviç, Sasha Milosavljeviç, Zoran Mojsiloviç dhe Mufera Serbica Shinik.

Pjesëmarrës tjerë: Senad Karaahmetovic OSBE; Pleurat Kurti EUSR; Ndiriçim Çekaj KDI; Zijush Ahmeti KSZ dhe Celal Iliaz, Drejtorja për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Personeli për mbështetjen e komisionit: Natasha Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Danush Ademi**, zëvendëskryetar i dytë i Komisionit.

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-145 për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë, me raport amendamente të Komisionit funksional për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Zëvendëskryetari -Danush Ademi, konstatoi se rendi i ditës miratohet njëzëri, pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-145 për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë, me raport amendamente të Komisionit funksional për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike.

Zëvendëskryetari, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 06/L-145 për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë, dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit, të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit funksional.

Pasi nuk kishte vërejtje plotësuese në projektligj dhe raportin me amendamente të Komisionit funksional, Komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Projektligji nr. 06/L-145 për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe rekomandohet të procedohet për miratim në Kuvend.

Mbledhja përfundoi në orën 9:45.

Përgatitur nga; Njësia mbështetëse e Komisionit

Zëvendëskryetar i Komisionit

Danush Ademi